



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 943 prot.

Vlorë, më 22.01 2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2024

**MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE
NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN SI DHE NGA FONDET
E BUXHETIT VENDOR.**

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencen sociale ne Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr 617 date 22.9.2022, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin Nr 597 date 4.9.2019 te Keshillit te Ministrave”Per percaktimin e procedurave ,te dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike “te ndryshuar Udhëzimin nr. 5 datë 17.02.2017,pika 1 dhe 4, “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” i ministrisë përkatëse, neni 24 te Ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore “si dhe në bazë të materialit të paraqitur nga Drejtorja e Ndihmës dhe Shërbimit Social, Këshilli i Bashkisë

V E N D O S I:

- I. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga fondet e buxhetit vendor për bllok-ndihmën si më poshtë:
 1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit për mos paraqitje tek zyra e punës për muajin përkatës,për mos gjenerim të deklaratës tremujore, për mos tërheqje të ndihmës mujore ,për arsye shendetsore, fatkeqësi familjare e të tjera, të vërtetuara këto me dokumenta justifikuese.
 2. Familje me kryefamiljarë femra në vështirësi ekonomike dhe sociale,
 3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune në kushte varfërie ekstreme,
 4. Familje me probleme të thella sociale që nuk mundin të realizojnë proceset gjyqësore për zgjidhje martesë dhe vendimet për UMM.

5. Familje ekstremisht të varfëra që kanë në përbërje fëmijë që ndjekin universitetin;
 6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare me paaftësi/sëmundje të rënda të cilat nuk përfitojnë nga KMCAJ-ja dhe janë në kushte të vështira socio-ekonomike;
- II. Familjet që do përfitojnë nga kriteret e mësipërme duhet të jenë familje që nuk klasifikohen nga sistemi i pikëzimit si familje në nevojë si edhe refuzohen/përjashtohen për një periudhë 6 mujore rastet e parashikuara në Kreun II pika 11 të Vendimit nr. 597 datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave , por që këto raste vertetohen si veprime jo të qëllimshme.
 - III. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas VKM nr.597 datë 04.09.2019“Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” ,të gjitha familjet do të trajtohen me ndihmë ekonomike pasi të jetë kryer paraprakisht vlerësimi socio-ekonomik në familje;
 - IV. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas Vendimit nr 617 date 22.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr 597,date 4.9.2019 te Keshillit te Ministrave “Per percaktimin e procedurave,te dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike “te ndryshuar.
 - V. Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë - Buxhetit dhe Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social .
 - VI. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1/1 a dhe 1/1 b .

Konceptoi: *K.Billa*
Miratoi: *I.Stasa*
Pranoi: *D.Demiri*

K R Y E T A R

Ermal Dredha

